



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONERI PER MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 7, Date 18.01.2016

Pasi u njoh me ankesen nr. 86, date 20.10.2015, e Z. N. V, Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Mbeshtetur ne nenin 32, pika 1, germa a), te ligjit nr.10 221, date 04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi", prane Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi, eshte paraqitur ankesa nr. 86, date 20.10.2015, e Z. N. V, i cili pretendon se eshte diskriminuar per shkak te gjendjes shendetesore, nga ana e Bankes se Shqiperise.

Sipas shpjegimeve te dhena ne ankese, Z. N. V eshte diplomuar ne vitin 1997, ne ne degen "administrim biznesi" prane Fakultetit te Ekonomise, te Universitetit te Tiranës. Fillimisht, nepermjet shkreses nr. 9267, date 18.11.2009, te Guvernatorit te Bankes se Shqiperise, ankuesi eshte emeruar per nje periudhe 6 mujore, ne detyren "specialist" ne Zyren e Mirembajtjes dhe Sherbimeve, prane Departamentit te Administrimit. Ne vijim, nepermjet shkreses nr. 4068, date 13.05.2011, te Guvematorit te Bankes se Shqiperise, emerimi i tij ne kete detyre eshte bere definitiv. Ne muajin qershor 2013, ankuesi eshte diagnostikuar me kancer te zorres se trashe dhe i eshte nenshtruar fillimisht nje nderhyrjeje kirurgjikale e ne vijim radio terapise dhe kemio terapise. Pavaresisht sa me siper, pas 2 muajsh me raport paaftesie ne pune, Z. V. rifillon pune ne pozicionin e meparshem te punes. Me pas, ai pretendon se eshte detyruar nga eprori i tij, Z. A. S. te beje nje kerkese per te levizur ne nje vend pune me te pershtatshem per shendetin e tij. Duke qene se Z. V. eshte ndodhur ne nje gjendje te renduar



Adresa: Rruga Sarni Frasheri, Nr.10, Kati II, Tirane
(Tek godina e Fondit Shqiptar tC Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

shendetesore (fizike dhe psikologjike), si dhe ne kushtet e nje gjendjeje te renduar ekonomike te farniljes se tij, e ka nenshkruar kerkesen e siperpermendur.

Per sa me siper, ne muajin janar 2014, ai eshte emeruar ne detyren "mirembajtes", ne Zyren e Mirembajtjes dhe Sherbimeve, prane Departamentit te Administrimit. Ne kete menyre, ai ka kaluar nga nje pozicion pune, ne pershtatje me arsimin dhe kualifikimet e tij, ne nje pozicion tjeter pune, ku si kriter punesimi ishte arsimi i mesem.

Ne keto kushte, Z. V. i eshte drejtuar Z. G. S., Guvernator i Bankes se Shqiperise, me kerkesen nr. 262, date 26.06.2015, ku kerkon te riemrohet ne pozicionin e meparshem te punes. Ne vijim te kerkeses se tij, nepermjet shkreses nr. 3891, date 29.06.2015, Guvernatori i Bankes se Shqiperise, nderpret marredheniet e punes se Z. V. me kete institucion.

Hapat procedurale te ndjekur nga strukturat perkatese te Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si me poshte vijojne :

1. Pas analizimit te ankeses nr. 86, date 20.10.2015 e Z. N. V, u konstatua se nga pikeparnja formale, ajo i plotesonte kerkesat e parashikuara nga nenin 33, pika 3 te ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 "Per Mbrojtjen nga Diskriminimi". Per kete arsye, Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat perkatese per shqyrtimin e saj.
2. Mbeshtetur ne nenin 33, pika 1, te ligjit nr. 10 221/2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bankes se Shqiperise, me shkresen nr. 87511, date 27.10.2015, ku kerkohej informacion, lidhur me Ceshtjen e ankuesit N. V.
 - Ne pergjigje te shkreses se siperpermendur, Banka e Shqiperise dergoi shkresen nr. 5467/1, date 26.11.2015, ku jepen sqarimet perkatese mbi ceshtjet e ngritura nga Z. V. .

Referuar kesaj shkrese, Z. N. V eshte emeruar prane Bankes se Shqiperise, ne daten 18.11.2009 ne pozicionin "specialist" prane Sektorit Teknik dhe te Sherbimeve, Departamenti i Administrimit. Kete pozicion, punonjesi e ka mbajtur deri ne daten 22.12.2013, kur eshte riemruar si "Mirembajtes" prane Departamentit te Administrimit.

Ne lidhje me pretendimin e Z. V. se eshte detyruar nga eprori i tij, Z. A. S. te levize ne nje vend tjeter pune dhe se ankuesi ka qene i detyruar te pranoje, Banka e Shqiperise sqaron se levizjet paralele ne pozicione me te larta apo me te uleta ne hierarkine e Bankes se Shqiperise jane te percaktuara ne Rregulloren "Per marredheniet e punes se personelit te Bankes se Shqiperise". Ne nenin 34, pika 1 te kesaj rregulloreje percaktohet se Guvematori kryesisht ose

¹ Neni 33, pika 7, i ligjit IO 22112010, parashikon : "Me 1narfjen e ankesi!s, komisioneri verifikon faktet. Per ki!ti! qi!llim, komisioneri mund t'u kiirkoji! ankuesit dhe personit kundi!r ti! ciliti ishti! drejtuar ankesa, tif paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 diti!ve nga dita qiipali!t marrin njofhnzin. Kur e 9mon ti! nevojshe, komisioneri merr informacione dhe nga 9doperson ose burim tjeti!r".



Adresa: Rruga Sarni Frasheri, Nr.10, Kati II, Tirane
(Tek godina e Fondit Shqiptar te Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@Wkmd.al
web:www.kmd.al

mbeshtetur ne propozimin e Departamentit te Burimeve Njerezore, ka te drejte te riemeroje ne cdo kohe punonjesit, ne pozicione paralele ose ne pozicione me te larta apo me te ulta ne hierarkine organizative te bankes se Shqiperise, kur kjo levizje cmohet e nevojshme ose e arsyeshme per administrimin efikas te burimeve njerezore ne Banke. Levizja e Z. V., ne pozicionin qe kishte deri ne momentin e nderprerjes se marredhenies se punes eshte here ne perputhje me aktet rregullative te Bankes se Shqiperise, per me teper qe ne rastin e Z. V., levizja ne nje pozicion tjeter ka qene e vetekerkuar, sikurse rezulton edhe nga shkresa e dates 02.12.2013, qe ky i fundit i ka drejtuar drejtuesit te njesise prane se ciles punonte.

Sipas shkreses se siperpermendur sqarohet se Banka e Shqiperise ka nisur zgjidhjen e marredhenieve te punes me Z. V., ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Kodin e Punes dhe nepermjet shkreses nr. 3785 prot., date 22.06.2015 ka njoftuar Z. V. mbi zhvillimin e takimit me perfaqesues te Departamentit te Burimeve Njerezore, ku do te diskutohej vazhdimesia e marredhenieve te punes te ankuesit me Banken e Shqiperise. Takimi i siperpermendur ndermjet perfaqesuesve te Departamentit te Burimeve Njerezore dhe Z. V. eshte zhvilluar ne daten 26.06.2015 dhe ne vijim te ketij takimi, pas permbushjes se afateve te percaktuara ne Kodin e Punes, Z. V. eshte njoftuar me Urdherin nr. 3891, date 29.06.2015 te Guvematorit te Bankes se Shqiperise, per nderprerjen e marredhenieve te punes me kete institucion

Ne shkrese theksohet fakti, se nderprerja e marredhenieve te punes me Z. V. , ndryshe nga sa shprehet ai ne ankesen e tij, nuk ka ardhur si pasoje e shkreses nr. 262, date 26/06.2015 te ankuesit, drejtuar Guvematorit te Bankes se Shqiperise, ku kerkohet kthimi i tij ne pozicionin e meparshem te punes, por si pasoje e procedurave te nisura nga Banka per nderprerjen e marredhenieve te punes. Ne kete parashtrim, Banka e Shqiperise sjell ne vemendje te Komisionerit se gjate procedures se nderprerjes nuk ka ekzistuar asnje nga shkaqet e parashikuara ne nenin 147 te Kodit te Punes, te cilat do te mund te shkaktonin pezullimin e procedures per nderprerje te marredhenies se punes.

Nder te tjera, Banka e Shqiperise sqaron se pervec zbatimit te procedurave dhe afateve perkatese, Banka e Shqiperise i ka akorduar Z. V., te gjitha perfitimet e mundshme te parashikuara nga Kodi i Punes, per rastet e largimit nga puna. Ne kete menyre, Banka e Shqiperise ka zbatuar ne menyre rigoroze parashikimet ligjore per nderprerjen e marredhenieve te punes dhe ne asnje rast ne qendrimin e saj nuk ka patur diskriminim kundrejt Z. V..

- ✚ Ne vijim te procedurave hetimore, referuar Urdherit nr. 180, date 02.12.2015 te Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi "Per kryerjen e inspektimit prane Bankes se Shqiperise, me qellim kryerjen e verifikimeve, mbi ankesen e Z. N. V", ekipi i inspektimit te KMD-se, ne daten 10.12.2015, kreu inspektim prane ketij institucioni.



Adrcsa: Rruga Sarni Frasheri, Nr.10, Kati II, Tirane
(Tek godina e Fondit Shqiptar tC Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info!@kmd.al
web:www.kmd.al

Objekti i inspektimit konsistonte ne si me poshte :

- Kryerja e verifikimeve mbi arsyet e levizjes se Z. N. V nga pozicioni "specialist" prane Sektorit Teknik dhe te Sherbimeve, prane Departamentit te Administrimit, ne pozicionin "PAM/Mirembajtes" prane te njejtit departament.
- Kryerja e verifikimeve mbi arsyet e nderprerjes se marredhenieve te punes se Z. V. me Banken e Shqiperise, nepermjet Urdherit nr. 3891, date 29.06.2015, te Guvematorit te Bankes se Shqiperise.
- Administrimi i kopjeve te akteve te meposhteme:
 1. Urdheri nr. 4068, date 13.05.2011, i Guvematorit te Bankes se Shqiperise, per emerimin e Z. N. V, ne pozicionin "specialist" prane Sektorit Teknik dhe te Sherbimeve, prane Departamentit te Administrimit.
 2. Urdheri i Guvematorit te Bankes se Shqiperise, per emerimin e Z. N. V, ne pozicionin "PAM/Mirembajtes", prane te njejtit departament.
 3. Propozimi i Departamentit te Burimeve Njerezore, drejtuar Guvematorit te Bankes se Shqiperise, per ndryshimin e pozicionit te punes se Z. V., referuar nenit 34, pika 1, te Rregullores se Bankes se Shqiperise.
 4. Shkresa nr. 262, date 26.06.2015 e Z. N. V, drejtuar Guvematorit te Bankes se Shqiperise, ku kerkohet rikthimi ne pozicionin e meparshem te punes.
 5. Urdheri nr. 3891, date 29.06.2015, i Guvematorit te Bankes se Shqiperise, nepermjet se cilit jane nderprere marredheniet e punes se Z. N. V, me kete institucion.
 6. Procesverbal i takimit te dates 26.06.2015, te perfaqesuesve te Departamentit te Burimeve Njerezore me Z. N. V.
 7. Raportet mjekesore te Z. V., te dorezuara prane Bankes se Shqiperise.

Gjate inspektimit, grupi i inspektoreve te KMD-se u takua me Z. E. P., me detyre Pergjegjes i Sektorit te Burimeve Njerezore, prane Bankes se Shqiperise dhe Znj. G. P., specialiste prane ketij sektori. Perfaqesuesit e Bankes se Shqiperise dorezuan tek inspektoret e Komisionerit, te gjitha aktet administrative te kerkuara ne urdherin e inspektimit. Pervec sa me siper, inspektoret e Komisionerit kerkuan te dispononin edhe disa akte te tjera administrative, per te cilat u ra dakord qe do te dergoheshin ne vijim nga Banka e Shqiperise ne adrese te Komisionerit.

- Me shkresen nr. 608111, date 16.12.2015 te Bankes se Shqiperise, bashkelidhur u derguan aktet administrative te kerkuara nga Komisioneri.

Adresa: Rruga Sarni Frasheri, Nr.10, Kati II, Tirane
(Tek godina e Fondit Shqiptar tC Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
wcb:www.kmd.al

Per sa me siper, gjate shqyrtimit te kesaj ankese, Komisioneri ka marre ne shqyrtim vetem ato eshteje, qe bejne pjese ne kompetencat e tij, te parashikuara nga ligji nr.10 221, date 04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi".

Mbeshtetur ne provat e administruara nga te dy palet, rezultoi se:

Z. N. V eshte diplomuar ne vitin 1997, ne degen "administrim biznesi" prane Fakultetit te Ekonomise, te Universitetit te Tiranës. Qe prej vitit 2009, ai ka punuar ne detyren "specialist" ne Zyren e Mirembajtjes dhe Sherbimeve, prane Departamentit te Administrimit. Referuar karteles personale onkologjike nr. 2438, date 05.08.2018, te Z. V., fletes se biopsise per ekzaminimin histopatologjik nr. 8100-06, date 03.07.2013, si dhe nje sere ekzaminimesh laboratorike rezulton se ne vitin 2013, ankuesi eshte diagnostikuar me kancer te zorres se trashe dhe i eshte nenshtuar fillimisht nje nderhyrjeje kirurgjikale e ne vijim radio terapise dhe kemio terapise. Pavaresisht sa me siper, pas 2 muajsh me raport paaftesie ne pune, Z. V. rifillon pune ne pozicionin e meparshem te punes. Ne daten 02.12.2013, ankuesi i drejton nje kerkese me shkrim, Drejtorit te Departamentit te Administrimit, nepermjet se ciles kerkohej mundesia e levizjes ne nje pozicion tjeter pune, me te pershtatshem, ku te konsiderohej e arsyeshme nga eprori, duke u nisur nga gjendja e tij shendetesore. Ne ankesen e tij, Z. V. pretendon se eshte detyruar nga eprori i tij, Z. A. S. te beje kete kerkese dhe duke qene se ai eshte ndodhur ne nje gjendje te renduar shendetesore (fizike dhe psikologjike), si dhe ne kushtet e nje gjendjeje te renduar ekonomike te familjes se tij, ai e ka nenshkruar kerkesen e siperpermendur. Per sa me siper, Komisioneri vlereson se nuk disponon prova dhe fakte konkrete, nepermjet se cilave te mund te vertetohet pretendimi i Z. V.. Per sa kohe, qe kerkesa e Z. V. mban nenshkrimin e tij, si dhe eshte dorezuar zvrtarisht prane eprorit te tij, kjo kerkese do te konsiderohet e mireqene.

Ne vijim te kerkeses se Z. V., Drejtori i Departamentit te Administrimit, nepermjet shkreses nr. 1846, date 06.12.2013, i drejtohet Departamentit te Burimeve Njerezore te Bankes se Shqiperise, ku kerkohet te merret ne konsiderate kerkesa e Z. V.. Referuar Urdherit nr. 2829, date 23.12.2013, te Guvernatorit te Bankes se Shqiperise, si dhe kontrates individuale te punes se lidhur ndermjet Bankes se Shqiperise dhe Z. N. V, ky i fundit kalon ne detyren "Mirembajtes", per nje periudhe 6-mujore.

Nese i referohemi pershkrimin ose manualit te punes se pozicionit te mirembajtesit, ky i fundit kryen detyra te nje karakteri teknik per mirembajtjen e objektit, ndaj edhe si kriter punesimi kerkohet arsimi i mesem. Ne manualin e vendit te punes "mirembajtes", parashikohet:

"II.Detyrat dhe pergjegjesite kryesore:

- *Realizon mirembajtjen e pajisjeve te ndryshme mekanike ne ndertesen e bankes, objekte dhe deget e bankes se Shqiperise.*



Adresa: Rruga Sarni Frasheri, Nr.10, Kati II, Tirane
(Tek godina e Fondit Shqiptar tC Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: inforti@kmd.al
web:www.kmd.d

- Ndjek r;do diti! mbari!vajtjen ni! pajisjet dhe sistemet mekanike dhe trajton te gjitha problemet e konstatuara prej tij ose te lajmeruara nga Departamentet e tjera qe lidhen me detyrat e tij.
- Kontrollon, verifikon dhe eleminon defektet ni! sistemet, rrjetet dhe pajisjet qe mbulon, sipas detyrave personale dhe ato te urdheruara nga P!rgjegj!si i Zyres, duke lene shi!nimet perkatese ni! librin ditor tepuni!s.
- Merr pjese ne grupe pune sipas programeve te miratuara per kete qi!llim.
- Zbaton detyrat e Zena nga Pergjegjesi i Zyri!s.

III. Njohurite dhe aftesite e nevojshme.

Arsimi i mesi!m profesional "

Nderkohe qe, Z. V. eshte diplomuar ne degen "administrim biznesi" prane Fakultetit te Ekonomise, te Universitetit te Tiranes, pra ka arsim te larte. Ne kete kontekst, vihet re nje mosperputhje e nivelit dhe arsimit te Z. V. , me nivelin dhe arsimin e pozicionit te punes "mirembajtes", pozicion ne te cilin eproret e tij kane vendosur ta emerojne. **Giithashtu, nese do te analizojme serisht manualin e punes se pozicionit te mirembajtesit, konstatohet se detyrat e ketij pozicioni kane karakter teknik dhe fizik, detyra te cilat, ne vleresimin e Komisionerit, duke patur parasysh diagnozen e semundjes se Z. V. , si dhe duke patur parasysh faktin, se ai ndodhej ende ne trajtim mjekesor ne seanca kemioterapie, nuk jane ne pershtatje me gjendjen e tij shendetesore.**

Pavaresisht se ekziston nje kerkese me shkrim e Z. V. , ku kerkohet kalimi ne nje pozicion tjeter pune, me te pershtatshem me gjendjen e tij shendetesore, nuk do te thote qe ai ka kerkuar te kalohet ne nje pozicion pune me te ulet, si per sa i perket nivelit e gjendjes arsimore, ashtu edhe trajtimit te tij financiar.

Ne perfundim te periudhes 6 mujore, te parashikuar ne kontraten individuale te punes, si dhe ne Urdherin nr. 2829, date 23.12.2013, te Guvematorit te Bankes se Shqiperise, Znj. J. M., Drejtore e Departamentit te Administrimit i ka drejtuar shkresen nr. 3745, date 18.06.2015, Departamentit te Burimeve Njerezore, ku behet fjale per vazhdimesine e marredhenieve te punes se Z. V. me institucionin e Bankes se Shqiperise. Sipas kesaj shkrese rezulton se: "Gjate periudhes 6-mujore (dhjetor 2014 – maj 2015) te punes ne Departamentin e Administrimit, (objektin Berat) Z. V. ka realizuar miri!mbajtjen e objektit.

- Ka pi!rmbushur detyrat sipas manualit tepunes se mirembajti!sit ti! objektit.
- Ka krijuar marri!dhenie shumi! te mira me koleget duke slifaqur dhe aftesi per te punuar ne grup.
- Eshte korrekt ne r;dopergjegj!si qe i eshti! ngarkuar.



Adresa: Rruga Sarni Frasheri, Nr.10, Kati II, Tirane
(Tek godina e Fondit Shqiptar tC Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web:www.kmd.al

Ne zbatim te detyrave te ngarkuara Z. V. ka treguar pergjegjshmeri dhe aftesi ne perballimin e situatave kritike, komunikuese dhe nderton me lehtesi marredhenie bashkepunimi.

Pavari!sisht sa me siper, mendojme qe nuk eshte me e nevojshme rinovimi i kontrates se punes me Z. N. V."

Sikurse vihet re nga citimi i aktit administrativ te siperpermendur, pavaresisht se eprorja e Z. N.V, ka kryer nje vleresim te mire per punen e tij, ne perfundim te ketij vleresimi, sugjeron qe nuk eshte me e nevojshme rinovimi i kontrates se punes me ankuesin. Permbajtja e shkreses nr. 3745, date 18.06.2015, te Znj. J. M., me detyre Drejtore e Departamentit te Administrimit hie ne kundërshtim dhe nuk justifikon perfundimin e nxjerre nga ana e saj.

Ne vijim, Z. V. i eshte derguar shkresa m. 3785, date 22.06.2015, ku njoftohet per nje takim, ne lidhje me vazhdimesine e marredhenieve te punes, takim i cili eshte realizuar ne daten 26.06.2015, ne ambientet e Departamentit te Burimeve Njerezore te Bankes se Shqiperise. Referuar procesverbalit te ketij takimi rezulton se Z. V. eshte shprehur: *"Une kam bere pune krahu, gii! per te cilen une nuk jam arsimuar, ne nje moment shume te veshtire te jetes time, ne nje moment qe une bej kemioterapi.....E kam te pamundur te ushtroj detyren e mirembajtesit,per efekt te gjendjes time shendetesore"*.

Referuar procesverbalit te takimit te dates 26.06.2015, Z. N. V thekson faktin se e ka te pamundur te ushtroje detyren e mirembajtesit, per efekt te gjendjes se tij shendetesore. Ne te njejten date, ai i drejtohet Guvematorit te Bankes se Shqiperise, me shkresen m. 262, date 26.06.2015, ku kerkon te riemrohet ne pozicionin e meparshem te punes dhe zgjidhja e dhene, ne rastin konkret nga ana e Bankes se Shqiperise, permblidhet ne Urdherin m. 3891, date 29.06.2015, te Guvematorit te Bankes, nepermjet se cilit nderpriten marredheniet e punes me Z. V.. Ne Urdherin e siperpermendur konstatohet se nnk eshte vene asnje motivacion, per nderprerjen e marredhenieve te punes se ankuesit me Banken e Shqiperise.

Ne nenin 7, pika 1, te ligjit m.10 221, date 04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi", parashikohet: *"(do veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose ipersonave fizike ajuridike qe marrin pjese ne jeten dhe sektoret publike ose private, qe krijojne baza per mohimin e barazise ndaj nje personi apo grupi personash, ose qe iekspozon ata ndaj nje trajtimi te padrejte dhe jo te barabarte, kur ata ndodhen ne rrethana te njejta ose te ngjashme, ne krahasim me persona te tjere ose grupe te tjera personash, perben diskriminim "*.

Nga analizimi ne teresi i fakteve te siperpermendura, Komisioneri gjykon se Z. V. eshte ekspozuar ndaj nje trajtimi te padrejte nga ana e Bankes se Shqiperise, per shkak te gjendjes se tij shendetesore.



Adresa: Rruga Sarni Frasheri, Nr. 10, Kati II, Tirane
(Tek godina e Fondit Shqiptar te Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info/Qlkmd.al
web:www.kmd.al

Ne baze te ligjit nr.10 221, date 04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka targer per dhenie demshperblimi moral (financiar), ndaj ankuesi duhet t'i drejtohet gjykates, per te perfituar kete demshperblim.

PERKETO ARSYE :

Mbeshtetur ne nenet 1,2 3, pika 1, nenin 4, pika 1, nenin 7, pika 1, nenet 12, 13 e 15, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 e 10 te Ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi",

Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, per shkak te gjendjes shendetesore, te Z. N. V nga ana e Bankes se Shqiperise.
2. Referuar pikes 1 te ketij Vendimi, te merren masa te menjehereshme nga ana e Bankes se Shqiperise, per rikthimin ne pune te Z. V. , ne nje pozicion pune ne perputhje me nivelin e tij arsimor dhe ne pershtatje me gjendjen e tij shendetesore.
3. Brenda 30 (tridhete) diteve nga marrja dijeni per kete vendim, Banka e Shqiperise, te njoftoje Komisionerin, lidhur me masat e marra per zbatimin e ketij vendimi.
4. Ne referim te nenit 33, pika 11, te ligjit nr. 10 221, date 04. 02. 2011, "Per mbrojtjen nga diskriminimi ", moszbatimi i ketij vendimi sjell si pasoje ndeshkimin me gjobe, sipas parashikimeve te pikes 13, te po ketij neni.
5. Kunder ketij Vendimi lejohet ankim prane gjykates kompetente.

Ky Vendim hyn ne fuqi menjehere.



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al